



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 958/13 Prot.

Vlorë më, 19.03.2025

VENDIM

Nr. 37, datë 19.03.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR .16 DATË
06.05.2021. "PËR MIRATIMIN E PROÇEDURËS SË APLIKIMIT, MIRATIMIT,
IMPLEMENTIMIT DHE PAGESËS SË MINIPROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA
BUXHETI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Mbështetur ne nenin 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 19 në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, referuar shkresës Nr. 955., prot datë 19.03.2025 ardhur nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.03.2025

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e Senatit Akademik Nr.16 datë 19.03.2021 "Për miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit, implementimit dhe pagesës së miniprojekteve të financuara nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë , si më poshtë vijon:
 - "Për miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit, implementimit dhe pagesës së Projekteve të Kërkim- Zhvillimit me financim të brendshëm nga buxheti i UV-së" (PKZHUV).
2. Vendimi i bëhet me dije Njësite Kryesore dhe Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

Miratolet
Dr. Rektori
Prof. Aurela Saliaj
Byroja

Nr. *955* Prot.

Vlorë, më *19* / *3* / 2025

Lënda: Propozim për një ndryshim në Vendimin e Senatit Akademik me nr. 16, datë 06.05.2021

PROF. DR. AURELA SALIAJ
REKTORE E UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

KËTU

Mbështetur në nenin 93 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kreun VI nenet 22 dhe 24 "Financimi i Kërkimit Shkencor" dhe "Projektet Kërkimore-Shkencore. Thirrja për projekte" Rregulloren financiare të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë miratuar me Vendimin nr 45 datë 05.12.2023 nga Bordi i Administrimit, nenin 85 të Statutit të UV-së, nenin 113 të Rregullores së UV-së, propozojmë ndryshimet e mëposhtme në tekstin e Vendimit të Senatit Akademik Nr. 16, datë 06.05.2021, "Për miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit, implementimit dhe pagesës së mini-projekteve të financuara nga buxheti i UV-së" me nr. 792/4 prot., datë 07.05.2021:

1. Zëvendësimin e fjalës "Mini-projekte" me "Projekte", si më e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse për t'iu referuar çdo forme financimi që konkretizohet me produkte shkencore dhe/ose zhvillimore.
2. Zëvendësimin e togfjalëshit "Mini-projekte të financuara nga buxheti i UV-së" me togfjalëshin "Projekte me financim të brendshëm nga buxheti i UV-së" (PKZHUV), si një term më specifikues për identifikimin e UV-së si financues i këtyre projekteve nga të ardhurat e veta.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin tuaj,

PËRGJEGJËSE SEKTORI
Artemida LUÇAJ